

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar, Driton Muharremi e Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Kimete Veseli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve S.K. nga Prizreni dhe M.K. nga Nishi, për shkak të veprës penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.2 e lidhur me veprën penale trafikim me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 dhe mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), B.M. nga Prizreni, Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.2 e lidhur me veprën penale trafikim me njerëz nga neni 171 par.3 dhe 2 lidhur me par.1 dhe mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), H.L...., G.M. nga Prizreni dhe A.R. nga Tirana, për shkak të veprës penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.1 e lidhur me veprën penale trafikim me njerëz nga neni 171 par.3 dhe 2 lidhur me par.1 dhe mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.2 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) duke vendosur përkritazi me ankesën e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve S.K. dhe M.K., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.83/16 datë 29.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), më 12.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

II. Aprovohen ankesat e mbrojtësve të akuzuarve S.K. dhe M.K. si të bazuara, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.83/16 datë 29.05.2017, vetëm përkritazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarin S.K. e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 3000 (tremijë) euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) viteve në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.07.2015 ndërsa të akuzuarën M.K. e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqindtë) euro dhe me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.07.2015.

III. Pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pa ndryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimi, P.nr.83/16 datë 29.05.2017, të akuzuarin S.K., e ka shpallur fajtor për veprën penale Trafikim me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPRK dhe i ka shqiptua dënim me gjobë në shumë prej 5000 (pesëmijë) euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 15.07.2015 dhe të akuzuarën M.K. për veprën penale Trafikim me njerëz nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPRK dhe i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej datës 15.07.2015.

Obligohen të akuzuarit S.K. dhe M.K. që dënimin me gjobë ta paguajnë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse nuk dëshirojnë ose nuk mund ta paguajnë gjobën atëherë gjykata do ta zëvendësoje dënimin me gjobë në dënim me burgim ashtu që një ditë burgim do të llogaritet me 20 euro gjobë.

Nga e akuzuara M.K. konfiskohet vetura e tipit “Daewoo Matis” me nr. të targave NI 110-BF me nr. serik KLA 4 M II, SD 4 C 946560 si mjet kryesorë së veprës penale.

Të akuzuarës M.K. i kthehet një telefon IPHONE – 6 me nr.049-444-127.

Të akuzuarit S.K. i kthehet telefoni i markës “SAMSUNG” me nr.044-955-595.

Të dëmtuarit T.K., J.Z., D.M., F.P. dhe R.K. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohen të akuzuarit S.K. dhe M.K. që në emër të paushallit gjyqësorë secili prej tyre të paguajnë shumën me nga 350 Euro, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit

Konform nenit 364 par.1 p.1.3 të KPP janë lirar nga akuza të akuzuarit S.K. dhe M.K., për shkak të veprës penale pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.2 të KP lidhur me veprën penale mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.2 lidhur me par.1 të KP, i akuzuari B.M. për shkak të veprës penale pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.2 të KP lidhur me veprën penale trafikimi me njerëz nga neni 171 par.3 dhe 2, lidhur me par.1 te KP dhe mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.2 lidhur me par.1 të KP, si dhe të akuzuarit, H.L., G.M. dhe A.R. për shkak të veprës penale pjesëmarrja dhe organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.2 të KP lidhur me veprën penale trafikimi me njerëz nga neni 171 par.3 dhe 2, lidhur me par.1 te KP dhe mundësimi ose detyrimi në prostitucion nga neni 241 par.2 lidhur me par.1 të KP.

Të akuzuarit A.R. i kthehet vetura e tipi “Opel Astra” me ngjyrë hiri me nr. regjistrimi AA 076 HB si dhe një telefon “SAMSUNG” dhe një “IPHONE”si dhe SIM kartela e Vodafonit me nr. XXXX.

Te akuzuarit B.M. i kthehet telefoni i markës “SAMSUNG”.

Të akuzuarit G.M. i kthehet telefoni i markës “NOKIA” me nr. serik 2330 dhe një SIM kartel e Z.Mobile me nr.xxx.

Konform nenit 454 par.1 të KPP shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj në tërësi ankesën ndërsa aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prizren sa i përket pjesës liruese ta ndryshoj dhe ti shpallë fajtorë, ndërsa kur janë në pyetje sanksionet penale të shqiptuara kundër të akuzuarit S.K. dhe M.K. ti ndryshoj dhe tiu shqiptoj dënime më të rënda apo lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën Themelore në Prizren.

-Mbrojtësi i të akuzuarit S.K. av. F.J. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale , për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoi ashtu që të akuzuarin S.K. ta liroj nga akuza ose të shqiptoj një dënim më të butë ose aktgjykimin ta prishë dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

-Mbrojtësi i të akuzuarës M.K. av. R.K., për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penale në dëmin e të akuzuarit dhe vendimit të gabuar për dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe të akuzuarën M.K. ta lirojnë nga aktakuza, gjithashtu të njëjtës ti kthehet automjeti i konfiskuar, sepse e njëjta nuk është pronare e tij.

-Përgjigje në ankesën e prokurorisë kanë ushtruar mbrojtësit e të akuzuarve B.M. av. B.E. dhe të akuzuarit H.L. av. Rr.K. duke propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoj dhe e mbajti seancën kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Nuk prezantoi Prokurori i Apelit, të akuzuarit H.L., G.M. dhe A.R.j, ndërsa prezent ishin të akuzuarit S.K. dhe M.K., mbrojtësi av. R.K. dhe av. F.-G.B. e caktuar sipas detyrës zyrtare dhe i akuzuari B.M., mbrojtësi i tij av. B.E. dhe mbrojtësi i të akuzuarit H.L. av. Rr.K.. Mbrojtësja e të akuzuarit S.K. mbeti pranë ankesës së ushtruar nga kolegu i sajë av. F.J. e po ashtu edhe mbrojtësi i të akuzuarës M.K. av. R.K. i cili propozon si në ankesë por nëse gjykata gjen se është fajtor të njëjtit të i shqiptoj dënim më të butë. Të akuzuarit S.K. dhe M.K. përkrahën fjalën e mbrojtësve të tyre. Mbrojtësit av. B.E. dhe av. Rr.K. propozuan që ankesa e

prokurorisë të refuzohet si e pa bazuar. I akuzuari B.M. përkrahi fjalën e mbrojtësit të tij.

Gjykata e Apelit pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat e mbrojtësve të akuzuarve S.K. dhe M.K. janë të bazuara ndërsa ajo e Prokurorisë Themelore në Prizren është e pa bazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë atakohet nga ana e mbrojtësve të akuzuarve S.K. dhe M.K., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që sipas mbrojtësit av. F.J. thekson se i mbrojturi i tij nuk ka qenë i përfshirë në trafikim me njerëz dhe asnjë rol apo kontribut nuk ka pasur në këtë pretendim inkriminues. Aktgjykimi është i bazuar në prova të pa pranueshme dhe të manipulueshme. Nuk bëhet fjalë në aktgjykim se kënd e ka rekrutuar S.K., strehuar apo ka pranuar dikë me qëllim të trafikimit dhe se të dëmtuarat nuk kanë deklaruar të ketë rekrutuar, strehuar, transferuar apo ti ketë detyruar ose sugjeruar të kenë marrëdhënie seksuale me klient e lokalit “M...x” apo të ketë përqindje. Nuk janë paraqitur arsyet vendimtare për çdo pikë të aktgjykimit ashtu siç parashihet me nenin 370 par.6, 7, 8 të KPP. Ndërsa mbrojtësi i të akuzuarës M.K. av. R.K. konsideron se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat janë prezentë në aktgjykim kanë të bëjnë me nenin 384 par.1 nën.par 8 dhe 12 të KPP e që lidhen me nenin 370 të KPP. Po ashtu aktgjykimi është i paqartë pasi në bazë të nenit 370 par.4 nuk përmban atë çka parasheh neni 365 par.1 nën.par 1 i KPP. Nuk përmendet se kur e mbrojtura e tij ka rekrutuar me qëllim të shfrytëzimit seksual të dëmtuarat D. dhe J., pa përmendur si dhe kur e po ashtu ti ketë dërguar me veturën e saj te moteli “Xx” i cili qenka larg nga shkolla 328.81 metra. Nuk thuhet se nga ky është larg ky motel nga shkolla dhe nuk thuhet se në cilin vend qenka zhvilluar aktiviteti kriminal. Konstatimi se 50% të shërbimeve seksuale i ka marrë nga R.K. dhe F. Patriti është kuturu dhe pa asnjë provë.

Gjykata e shkallës së parë me vëmendje ka shqyrtuar ankesën e mbrojtësve të akuzuarve S.K. dhe M.K. e që ka të bëjë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe vlerëson se pretendimet e tilla janë të pa bazuara. Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë, në të janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare, gjykata ka dhënë arsyet për çdo pikë të aktgjykimit duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse dhe duke dhënë arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike. Arsyet dhe vlerësimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë si të tilla i pranon edhe kjo gjykatë duke konsideruar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarit i ka shpallur fajtores për veprën penale nga neni 171 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Po ashtu aktgjykimi nuk përmban prova të pa pranueshme e të cilat do duhej të veçoheshin nga shkresat e lëndës me rastin e gjykimin të kësaj çështjeje në gjykatën e shkallës së parë.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës por edhe mbrojtësit e të akuzuarve S.K. dhe M.K. pretendojnë se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. PSRK në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka vërtetuar se të akuzuarit nuk kanë krye veprën

penale nga neni 283 par.2 të KPRK kur janë në pyetje të akuzuarit S.K., M.K. dhe B.M. pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me krim të organizuar – krim të rëndë të kryer nga grupi i strukturuar me qëllim të përfitimit të pasurisë materiale që ka veprua nga fillimi i vitit 2013 e deri në korrik të vitit 2015 i cili grup ka krye veprën penale të Trafikimit me njerëz dhe mundësimin ose detyrimin në prostitucion. Po ashtu kur janë në pyetje të akuzuarit H.L., G.M. dhe A.R. bazuar në faktin se këta kane veprua si grup që ka pasur 6 persona, kanë pasur rrollet e ndara dhe pandërprerë kanë kryer veprime kriminale. Ky grup i organizuar kriminal ka pas një hierarki, kanë marrë urdhra nga kryesuesi i grupit i akuzuarit S.K. i njohur në regjionin e Prizrenit i cili ka mbajtur në kontrolle të rrepte këtë veprimtari kriminale, ka kërkuar ta njoftojnë të pandehurit tjerë për të gjitha veprimet që kanë ndërmarrë dhe përfitimet që i kanë realizua ndërsa nga të dëmtuarat të cilat i kanë trafikuar dhe iu kanë mundësuar prostitucion ato të mbajnë shënime të plota sa herë kanë pasur marrëdhënie seksuale me klient që të paguajnë përqindjen e të hollave që do të i takonin këtij të akuzuari dhe të akuzuarve tjerë. Po ashtu i akuzuari S. me të akuzuarit B. dhe M. kanë organizuar shkuarjen e femrave – dëmtuarave të shumtën e rasteve në motelin “Xx” dhe “Nn” për të krye marrëdhënie me klient dhe janë angazhuar për sjelljen e femrave tjera nga Shqipëria dhe Serbia e tij., me qëllim të trafikimit. Kjo vërtetohet me faktin se një rast i akuzuari B. godet dy herë me shuplakë të dëmtuarën T.K. në prezencë të akuzuarit S. si dhe faktin se të gjitha femrat që kanë punuar në lokal lejet dhe daljet në qytet dhe çdo vonesë ose mos ardhje është dashur të i arsyetohen atij siç është ky rasti konkret kur i akuzuari A. e njofton për një vonesë të dëmtuarës J.I.. Sa i përket të akuzuarës M. përveç rekrutimit të dëmtuarave D. dhe J. duke i mashtruar fillimisht se do të punojnë si valltare për rrogën 500 euro të cilën asnjëherë nuk kanë arritur që ta marrin, u ka siguruar klient brenda klubit duke marrë 50% të çmimit si dhe me veturën e sajë i ka dërgua deri te motel “Xx” e pastaj i ka kthyer në banesë si dhe të dëmtuarat është dashur të marrin leje nga ajo për të dalë në qytet. Sa i përket të akuzuarit H.L. i njëjti edhe pse e ka ditë për shfrytëzimin seksual të femrave merr pjesë aktivisht në veprimtari kriminale të grupit kështu që i njëjti si pronar i lokalit “M...x” pas marrëveshjes me të akuzuarin S. ka lidh kontrata të punës me femra të huaja që kanë punua kinse si valltare dhe kameriere, u ka rregulluar dokumentet me qëllim të fshehjes së trafikimit të femrave ndërsa i akuzuari G.M. ka pas rolin e ndërmjetësit për shërbime seksuale ndërmjet femrave dhe klientëve ku 20 euro nga shuma e shërbimit i takonin atij. Ndërsa i akuzuari A.R. ka pasur për detyrë sjelljen e femrave nga Shqipëria për të punuar si valltare e pastaj me qëllim të shfrytëzimit seksual me anë të mashtrimit dhe lajthimit ndikon që të merren me shërbime seksuale me klient të ndryshëm. Gjykata nuk ka vërtetuar drejtë as alibinë e të akuzuarit B.M. lidhur me datën 08.08.2014 kur ka goditur me dy shuplaka të dëmtuarën Tatjana. Pothuajse të gjitha pjesët e dispozitivit të aktakuzës janë vërtetuar edhe nga deklaratat e të dëmtuarave- dëshmitareve D., J., R. dhe F. të dhëna në mundësinë e hetimit të veçantë.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.K. pretendon se aktgjykimi është i përfshirë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që aktgjykimi bazohet vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor e të cilat nuk kanë vërtetuar gjendjen faktike që e thot gjykata. Në aktgjykim përmendën emrat e dëshmitarëve H.H., S.TH. dhe A.XH., S.I. e O.J. por asnjëri në asnjë vend nuk e përmend M.K.. E vetmja provë që gjykata e merr të vërtetuar është mundësia hetuese e veçant ku deklaratat i kanë dhënë të dëmtuarat. Nuk është e vërtetë se e

mbrojtura e tij ka rekrutuar D. dhe J. për tu marr me prostitucion pasi asnjëra prej tyre nuk është e mitur dhe e kanë ditur se do të punojnë si valltare e që edhe para kësaj ato kanë ushtruar profesionin e valltares por edhe janë marr me prostitucion.

Sa i përket gjendjes faktike, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë. Sa i përket të akuzuarit S.K. gjendja faktike është vërtetuar nga dëshmitë e të dëmtuarave të cilat janë dëgjuar në cilësinë e dëshmitareve në mundësinë hetuese të veçant: F.P., D. M., R.K., T.K. dhe J. ZH., të cilat kanë deklaruar se ato në lokalin “M...x” kanë ardhur për të punuar kinse si kameriere-valltare, se kontratat e lidhura me pagë prej 500 eurove nuk i kanë marrë kurrë, se janë obliguar të ulen në tavolinë me klient që të pinë me ta dhe gjatë kësaj kohe kanë caktuar edhe takimet për shërbime seksuale të cilat i kanë kryer në motelin “Xx”, motel i caktuar nga ta, dhe se një orë për këto shërbime seksuale ka kushtuar 100 euro ku klienti ka qenë i obliguar që një shumë ta paguaj në lokal në emër të kaparit e pastaj pjesën tjetër në motelin “Xx”. Varësisht kush ja ka gjetur klientët vajzave kanë qenë të obliguar që të ja paguajnë edhe përqindjen. Ndërsa kur klientët i ka gjetur e akuzuara M.K. për J., D. dhe F. 50% ja kanë dhënë të akuzuarës M.. Të dëmtuarat nuk kanë pasur lirin e lëvizjes, nuk kanë guxuar që të dalin vetë në qytet por kanë dalë me të akuzuarën M. dhe atë J. dhe D.. E dëmtuara R. ka deklaruar se ka pas nevojë për të holla pasi e ka pas nënën e smut dhe për këtë arsye është marrë me prostitucion dhe ka pranuar që të ja jap gjysmën e të hollave M., e njëjta ka qenë edhe për të dëmtuarën F. e cila ka deklaruar se e ka pasur vajzën e sëmur dhe se rrogën e premtuar prej 500 euro nuk e ka marr kurrë. Po ashtu kjo gjendje faktike është vërtetu edhe nga dëshmitari H.H. i cili ka deklarua se ka krye marrëdhënie seksuale me Jn. tek vila duke shkuar për në Gjakovë, se i ka dhënë 200-300 euro që ta ndihmoj familjen e sajë. Se atë ditë kur ka pas marrëdhënie seksuale me Jn. e ka pas edhe një shokë të tij me emër D.K.. Edhe dëshmitari A.XH. ka deklarua se ka pas marrëdhënie me R. dhe me Jn., se ka qenë në lokalin “M...x” ndërsa pagesat i ka kryer pas marrëdhënies. Njëjtë ka deklaruar edhe dëshmitari S.TH. që ka pas marrëdhënie me Jn., ka paguar 100 euro dhe atë pas marrëdhënies seksuale. Vajzat kanë qenë të strehuara në dhomat sipër lokalit, por pasi është dëmtuar nga shiu strehuar tek vila “T...i”, e që e deklaroi edhe vetë i akuzuari S. dëshmia e të cilit përputhet edhe me ato të dëmtuarave në këtë drejtim por edhe për mënyrën se si kanë ardhur të dëmtuarat në Kosovë. Kjo gjykatë pajtohet me mendimin e gjykatës së shkallës së parë se të gjitha femrat kanë ardhur me pëlqimin dhe me dijeninë e të akuzuarit S.K. i cili si pronar i lokalit ka lidhur kontrata me to dhe i ka paguar ndërsa pretendimi i tij se ato kanë qenë të lira për të qarkulluar janë të pa baza dhe në kundërshtim me provat tjera por edhe me vetë dëshminë e të akuzuarës M.K. e cila ka deklaruar se femrat nuk kanë pas të drejtë të lëvizin sepse S.i ka thënë se është më mirë që ato të mos dalin për të mos i humbur klientët. Se i njëjti ka qenë në dijeni se ato kryejnë shërbime seksuale në shkëmbim të hollave. Një gjendje e tillë faktike është vërtetuar edhe nga provat materiale- masat e fshehta, simulimi i blerjes ku personat zyrtar kanë kontaktuar me femrat e lartcekura në lokal, janë marr vesh për çmimin dhe vendin ku do të kryhet shërbimi seksual e që ka qenë motel “Xx”, se duhet të paguhet me kapar ndërsa pjesa tjetër në motel prej shumës së përgjithshme 100 euro për një orë. Këto të holla janë përdor nga fondi i fshehte, janë regjistruar dhe janë përdorur për simulim të veprës penale e që janë gjetur tek e dëmtuara D. M.q dhe F.P. e që vërtetohet edhe nga bastisja e datës

15.07.2014 ku në katin e dytë të motel “M...s” në dhomën nr. 5 është gjetur D. M.q së bashku me oficerin policor që ka bërë simulimin e rastit ndërsa në dhomën nr. 4 është hasur F.P. me oficerin policor që ka marr pjesë në simulim. Prandaj bazuar në provat e cekura më lartë pa mëdysheje është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit S.K. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz e që janë rekrutimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave të trafikuar me qëllim të shfrytëzimit seksual me anë të kërcënimit, përdorimit të dhunës apo me format e tjera të detyrimit apo keqpërdorimit të pushtetit, të pozitës ose të një pozite të ndjeshme për të arritur pëlqimin e personit që ka kontrollë mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit e që kjo përfshinë edhe shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve ose formave të tjera për shfrytëzim seksual, e që pozita e ndjeshme ndër të tjera është vërtetua edhe me provën se të dëmtuarat R. dhe F. kanë pasur njëra nënën e tjetra vajzën e sëmur e që kjo i ka obliguar që të pranojnë të merren me prostitucion. Gjendja faktike është vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë edhe përkitazi me të akuzuarën M.K. e sidomos nga dëshmia e dëshmitares D. M.q të dhëna në procesverbalin e mundësisë hetuese të veçantë ku ka deklaruar se në Prizren ka ardhur së bashku me të akuzuarën M. dhe se për marrëdhëniet seksuale të kryera në hotelin “Xx” secilën herë 50% të shumës ja ka dhënë të akuzuarës M., se në motel ka shkuar me taksì apo e ka dërguar M. me automjetin e saj. Të njëjtën e ka deklaruar edhe dëshmitarja J. ZH. e cila në “M...x” ka ardhur përmes M. dhe se pas 5-6 dite ka pas marrëdhënie seksuale me myshteri të cilat ja ka caktuar M. dhe se me automjetin e saj e ka dërguar deri te moteli dhe secilën herë ja ka dhënë gjysmën e mjeteve. Njëjtë kanë deklaruar edhe e dëmtuara R.K. ku ndër të tjera ka deklarua se ka par J. dhe D. duke i dërguar e akuzuara M. me automjetin e vetë deri në motel dhe se edhe ajo ja ka dhënë gjysmën e të hollave e ashtu ka deklaruar edhe e dëmtuara F.. Mbrojtjen e të akuzuarës M.K. e demantojnë dëshmitë e të dëmtuarave por edhe provat materiale siç janë raportet e oficerëve policor që kanë zbatuar masat e fshehta – simulimin e blerjes por edhe raportin mbi bastisjen ku tek të dëmtuarat D. dhe R. janë gjetur në dhomën e oficerëve policor që kanë bërë simulimin e rastit. Ndërsa pretendimin e të akuzuarës se ajo nuk ka leje dhe nuk ka vozitur automjetin kjo është demantuar po ashtu nga dëshmitë e dëshmitareve D., J. dhe R.. Prandaj bazuar në këto prova të cekura më lartë pa mëdysheje është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Trafikim me njerëz pasi që ka ekzistuar shfrytëzimi për shërbime seksuale, gjetja e klientëve, marrja e gjysmës së të hollave por edhe transportimi i tyre nga “M...xi” deri në motel për të kryer marrëdhënie seksuale, se nuk kanë qenë të lira të dëmtuarat për të dalë lirshëm pasi e akuzuara nuk i ka lejuar por vetëm nën përcjelljen e sajë dhe se e njëjta përmes veprimeve të sajë – dhunës ka dashur që çdo marrëveshje të shkoj përmes sajë.

Sa i përket pretendimeve të prokurorisë përkitazi me veprën penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.2 të KPRK, ky pretendim është i pa bazuar dhe se gjykata drejtë ka vendosur kur të akuzuarin S.K. dhe M.K. për këtë vepër penale i ka liruar nga akuza me arsyetim se kjo nuk është vërtetuar me asnjë provë bindëse. Prokuroria nuk ka arritur ti provoj pretendimet e sajë të cilat i paraqet në formë të shkruar edhe në ankesë e tek këta të akuzuar kemi të bëjmë me një grup të strukturuar që ekziston për një kohë të caktuar e për qëllim të kryerjes së një apo më shumë krimeve të rënda. Nuk ka arritur të vërtetohet roli i të akuzuarve në organizimin, formimin, mbikëqyrjen apo drejtimin e veprimit të grupit kriminal të organizuar gjegjësisht

atë çka parashihet edhe me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër organizimit të kriminalitetit trans nacional, ku ky grup duhet të ketë së paku 3 persona, të ekzistoj një kohë të caktuar dhe të vepron në mënyrë të organizuar për të kryer një apo më shumë vepra të rënda penale e me qëllim të përfitimit financiar. Duhet që patjetër të përcaktohen rolet gjegjësisht ndarja e tyre brenda kësaj organizate të strukturuar kriminale, të dihet udhëheqësi dhe veprimet konkrete të secilit anëtarë të grupit dhe kontributi i tyre në kryerjen e veprës penale prandaj në mungesë të këtyre provave me të drejtë të akuzuarit gjykata e shkallës së parë i ka liruar për veprën nga neni 283 par.2 të KPRK por edhe të veprës penale nga neni 241 par.3 të KPRK duke vlerësuar se elementet e kësaj vepre penale janë konsumuar në veprën penale të trafikimit me njerëz pasi që kemi të bëjmë me përkufizim të njëjtte të disa veprimeve të cilat parashihen edhe në veprën penale të trafikimit dhe se tek mundësimi i prostitucionit personi që ushtron prostitucionin nuk është viktimë e trafikimit. Për veprën penale nga neni 283 par.2 e që lidhet edhe me trafikim me njerëz dhe mundësim të prostitucionit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarit B.M., H.L., G.M. dhe A.R.j i ka liruar nga akuza për veprat penale për të cilat kanë qenë të akuzuar me arsyetim se nuk është provuar se në veprimet e tyre ekzistojnë elementet e këtyre veprave penale. Prokuroria nuk ka arritur me asnjë provë ta vërtetoj rolin e të akuzuarve B., H.G. dhe A. në organizimin, formimin, mbikëqyrjen apo drejtimin e veprimit të grupit kriminal të organizuar ashtu siç u cekë më lartë si kërkohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara por edhe me Kodin Penal të Kosovës, nuk janë provuar se cilat janë veprimet konkrete të tyre, kontributi i tyre dhe përfitimi material e kjo nuk u provua as nga dëshmitë e të dëmtuarave të cilat nuk i kanë inkriminuar këta të akuzuar për ndonjë veprim e q asnjëra prej tyre nuk ka ditur të shpjegoj rolin që kanë pasur këta të akuzuar. Të akuzuarin B. vetëm e kanë par në lokal- në banak pranë kompjuterit, për të akuzuarin H. se ka qenë pronar veç me letra, i akuzuari Gëzim ka qenë kamerier dhe pastrues ndërsa i akuzuari A. i dashuri i Jn.. Është vërtetuar se Jn. nuk ka ardhë në Kosovë përmes A. R. e as B. M. por ka ardhur përmes A.C., ndërsa faktin se A.i e ka lajmëruar për vonesën e Jn. në punë , nuk është provuar se kjo provon ndonjë veprim inkriminues duke pas parasysh se ajo ka punuar tek “M...xi” me kontratë pune. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë nuk ka gjete elemente inkriminuese për të akuzuarin H.L. ku prokuroria thirret se në vitin 2015 i ka thënë T.K. të ketë marrëdhënie me dy shokë të tij në dy raste pa pëlqimin e saj mirëpo prokuroria nuk ka dhënë prova ush janë ata shokë, emrat e tyre, ku dhe kur ka ndodhur kjo, mënyrën e detyrimit për marrëdhënie seksuale dhe kompensimin eventual të sajë në të holla për këtë shërbim e që këto fakte kanë mbetur të pa provuara. Për të akuzuarin G.M. të dëmtuarat kanë deklarua se ka qenë kamerier dhe pastrues, nuk i kanë përmendur të ketë ndërmjetësuar ndonjëherë në mes klientëve për shërbime seksuale e as që të ja ketë dhënë nga 20 euro. Të akuzuarin A.R. gjykata e ka liruar në mungesë të provave pasi nuk është provuar se cilat janë ato femra të cilat i akuzuari A. i ka sjellë, emrat e tyre, mënyrën se si ka ndikuar tek ato për të kryer marrëdhënie seksuale me klient të ndryshëm dhe se kjo ngel vetëm në supozime, ndërsa sa i përket transkriptit telefonik të datës 12.06.2015 dhe 13.06.2015, është fakt se i akuzuari ka biseduar me një femër nga Shqipëria që ajo të vjen për të kryer marrëdhënie seksuale në Kosovë mirëpo prokuroria nuk ka arritur të vërtetoj se kush është ajo femër, a ka ardhur në Kosovë apo krejt ka ngelur në një bisedë realizimi i së cilës nuk u provua. Nuk është provuar fakti se ky i akuzuar i ka nën kontroll edhe dy femra tjera pasi nuk dihen kush janë këto femra, emrat e tyre dhe ndikimi i tij te ato për të kryer shërbime seksuale në

shkëmbim të te hollave. Prandaj me të drejtë siç u theksua edhe më lartë gjykata e shkallës së parë në mungesë të provave i ka liruar nga akuza të akuzuarit B.M., H.L., G.M. dhe A.R.j. Sa i përket pretendimit të mbrojtësit të akuzuarës M.K. lidhur me konfiskimin e veturës “Daewoo matis” me shënime si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, kjo gjykatë vlerëson se pretendimi i të akuzuarës se nuk vozit dhe nuk ka leje dhe pretendimi i mbrojtjes se vetura nuk është në emër të sajë, këto pretendime janë të pa bazuara pasi që siç u theksua më lartë këto demantohen nga dëshmitë e dëshmitareve-të dëmtuarave D., J. dhe R. të cilat kanë përshkruar mënyrën se si e akuzuara M. me automjetin e saj i ka dërguar D. dhe J. nga “M...xi” për në hotel “Xx” prandaj duke pas parasysh se vetura në fjalë ka shërbyer si mjet me të cilën është kryer vepra penale, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka marr vendim për konfiskimin e veturës në fjalë.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të prokurorit dhe të mbrojtësve të akuzuarve S.K. dhe M.K. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa e prokurorit është e pa bazuar ndërsa ato të mbrojtësve të akuzuarve janë të bazuara. Prokurori në ankesën e tij nuk ka cekur ndonjë rrethanë të re e që nuk ka qenë e njohur apo nuk është vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit S.K. ka konsiderua se dënimi është i lartë pasi nuk janë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit. Mbrojtësi i të akuzuarës M.K. ka theksuar se dënimi është i ashpër dhe i pa arsyetuar, më parë nuk ka qenë e dënuar dhe është nënë e një fëmije të mitur, me gjendje të varfër ekonomike. Kjo gjykatë vlerëson se duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cekura nga gjykata e shkallës së parë lidhur me të akuzuarit S.K. dhe M.K. dhe ate: qëndrimin korrekt të tyre gjatë gjykimit, se janë familjar, i akuzuari S. është i martuar dhe ka dy fëmijë ndërsa e akuzuara M.K. është e shkurorëzuar dhe nënë e një fëmije, ndërsa për të akuzuarën M. se është e gjendjes së dobët ekonomike, të akuzuarve ua ndryshoi dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimet shqiptuara janë të ashpra ashtu që të njëjtat duke u bazuar në dispozitën e nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së, kjo gjykatë vlerëson se këto dënime të shqiptuara nga kjo gjykatë janë në harmoni të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.441/2017, më 12.10.2017

Procesmbajtësja,
Kimete Veseli _____

Kryetari e kolegjit- gjyqtari
1.Xhevdet Abazi _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi _____

3. Fillim Skoro _____